

## **QYTETI I SHKUPIT**

Në bazë të pikës 5 të Programit për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2022 (“Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 4/22) dhe Vendimit për përcaktimin e vlerës maksimale për dhënien e subvencionit individual për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2022 (“Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 4/22), dhe në lidhje me nenin 4 të Rregullores për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2022 nr.6958/1 nga 16.06.2022, Qyteti i Shkupit shpall:

### **THIRRJE PUBLIKE**

#### **për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2022**

#### **1. Përshkrimi i Thirrjes publike**

1.1. Problemi kryesor në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, me të cilin ballafaqohet Qyteti i Shkupit, është cilësia e keqe e ajrit ambiental në qytet, veçanërisht grimcat partikulare (PM10 dhe PM2,5). Një nga arsyet kryesore për emetimin e këtyre grimcave është ngrohja e objekteve që nuk janë të lidhura me ngrohjen qendrore, para së gjithash, për shkak të djegies jo të plotë dhe joadekuate të drurëve të zjarrit, cilësisë joadekuate të drurëve dhe mënyrës së ruajtjes së tyre dhe përdorimit të stufave të vjetra, të amortizuara dhe teknikisht të parregullta, si dhe nga pastrimi dhe mirëmbajtja jo e rregullt e oxhaqeve.

Kjo masë ka për qëllim arritjen e efekteve afatshkurtra dhe disa efekteve afatgjata:

- Arritja e djegies më të mirë,
- Reduktimi i gazrave të dëmshëm,
- Reduktimi i blozës,
- Mbrojtja nga zjarri,
- Zvogëlimi i shpenzimeve për ngrohje;
- Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës, dhe
- Ngritja e vetëdijes publike të qytetarët për nevojën e pastrimit të oxhaqeve.

1.2. Mjetet financiare për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të bëra për pastrimin e oxhaqeve janë në vlerë neto maksimum deri në 1.200,00 denarë për amvisëri. Tatimi personal mbi të ardhurat është në barrën e Qytetit të Shkupit.

1.3. Në Thirrjen publike për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të amvisërive dhe subjekteve të tjera për pastrimin e oxhaqeve mund të marrin pjesë qytetarë vendbanimi i të cilëve është në territorin e qytetit të Shkupit (komunat e qytetit: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj).

1.4. Thirrja publike do të zgjasë nga dita e shpalljes duke përfshirë aktivitetet e realizuara për pastrimin e oxhaqeve nga 01.01.2022 deri më 30.11.2022,

përkatësisht deri në shfrytëzimin e mjeteve të parashikuara për këtë qëllim në Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2022.

1.5. Thirrja publike është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)), në mediumet e shtypura dhe elektronike (dhe atë më së paku në një nga gazetat ditore në gjuhën maqedonase dhe në një nga gazetat ditore në gjuhën shqipe) dhe mediet elektronike.

## **2. Kriteria për pjesëmarrje në Thirrjen publike:**

2.1. Aplikuesi është e nevojshme t'i plotësojë këto kushte në përputhje me Programin për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në qytetin e Shkupit për të kompensuar një pjesë të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2022 ("Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit" nr. 4/22 ):

- Të jetë banor i qytetit të Shkupit (komunat në qytet: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj;
- Adresa e pastrimit të realizuar të përputhet me adresën e kartës së identitetit të aplikuesit, të dhënë gjatë plotësimit të aplikimit elektronik në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit;
- Pastrimi i oxhakut të jetë kryer nga profesionist i punësuar në firmë të regjistruar me shifrën e veprimtarisë 81.22 në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive;
- Objekti ku do të pastrohet oxhaku të mos jetë në fazën e ndërtimit;
- Të posedojë vërtetim në origjinal dhe kupon fiskal origjinal për kryerjen e pastrimit të oxhakut me datë nga 01.01.2022 deri në shterimin mjeteve të dedikuara për Thirrjen publike, por jo më vonë se 30.11.2022.
- Të posedojë vërtetim origjinal të lëshuar nga oxhakpastruesi për pastrimin e oxhakut me datë nga 01.01.2022 deri në shterimin e mjeteve nga buxheti i dedikuar për Thirrjen Publike, por jo më vonë se data 30.11.2022.

## **3. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike**

3.1. Të drejtë për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike kanë qytetarët vendbanimi i të cilëve gjendet në territorin e qytetit të Shkupit: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj, të cilët do të pastrojnë oxhakun e vendbanimit të tyre dhe do të depozitojnë aplikim në formë elektronike të shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose direkt në link-un <https://www.uslugi.skopje.gov.mk>) për shfrytëzimin e së drejtës për kompensim.

3.2. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe për të konfirmuar që kriteret për pjesëmarrje janë plotësuar, aplikuesi detyrimisht duhet të depozitojë në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së internetit të Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose direkt në link-un <https://www.uslugi.skopje.gov.mk> dokumentacionin e mëposhtëm:

- Plotësimi i aplikacionit për subvencionim për pastrimin e oxhaqeve me të dhëna personale do të jetë në dispozicion në mënyrë elektronike nëpërmjet:

faqes së internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose direkt në link-un [https // www.uslugi.skopje.gov. mk](https://www.uslugi.skopje.gov.mk);

- Dëshmi për llogari personale: llogari personale transaksioni e skanuar e bashkangjitur në emër të aplikuesit;
- Faturë fiskale origjinale e skanuar e bashkangjitur për kryerjen e pastrimit të oxhakut;
- Vërtetim origjinal i skanuar i bashkangjitur nga oxhakpastruesi për kryerjen e pastrimit të oxhakut;

3.3. Aplikuesit duhet t'i lëshohet vërtetim për kryerjen e pastrimit të oxhakut dhe i njëjti të përputhet me adresën e vendbanimit (sipas deklaratës së bashkangjitur):

3.4. Vetëm një person nga amvisëria mund të depozitojë kërkesë për marrjen e kompensimit.

3.5. Plotësimi i kërkesës për shfrytëzimin e së drejtës për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhakut me të dhënat personale do të jetë në dispozicion formë elektronike nëpërmjet: faqes së internetit të Qytetit të Shkupit: [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose direkt në link-un [https//www.uslugi.skopje.gov.mk](https://www.uslugi.skopje.gov.mk)).

#### **4. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit**

4.1. Për të konstatuar përmbushjen e kushteve nga pika 2 e Thirrjes publike, kryetarja e Qytetit të Shkupit formon Komisionin për zbatimin e procedurës për subvencionimin e amvisërive të qytetarëve në territorin e qytetit të Shkupit për kompensimin e një pjese të shpenzimeve për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2022, i përbërë nga 7 anëtarë (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

4.2. Kryetarja e Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, sjell Aktvendim për miratimin e kërkesës dhe kompensimin e një pjese të shpenzimeve të bëra gjatë pastrimit të oxhaqeve për aplikuesit të cilët i kanë plotësuar kushtet nga pika 2 e kësaj Thirrjeje publike.

4.3. Në rast se kërkesa e paraqitur nuk pranohet, për shkak të depozitimit të dokumentacionit jo të plotë ose të parregullt, ose nëse aplikuesi nuk i plotëson kushtet nga pika 2 e Thirrjes publike, Qyteti i Shkupit do ta informojë me njoftim aplikuesin për arsyet përse nuk është pranuar kërkesa.

Nr. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT

SHKUP